



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 145/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.04.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “RA-MI Kompani” shpk nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF- 48940-02-04-2020, me objekt: “Furnizim me një ashensor të ri për godinën e hotelerise (Godina katër katëshe)”, me fond limit 3,200,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 24.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

Ankimues: “RA-MI Kompani” shpk
Adresa: Rruga “Tele Ndini”, Kati 1, Pallati 1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal Durrës.
Adresa: Rruga “A. Goga”, Lagjia Nr. 8, Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.02.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF- 48940-02-04-2020, me objekt: “*Furnizim me një ashensor të ri për godinën e hotelerise (Godina katër katëshe)*”, me fond limit 3,200,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 24.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.

II.2. Në datën 24.02.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 28.02.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Kleo-Ashensor” shpk	2,400,000 lekë	skualifikuar
2. “RA-MI Kompani” shpk	2,900,000 lekë	skualifikuar
3. “AL-EK Consulting” shpk	3,090,000 lekë	skualifikuar
4. “Hymeri Kleemann” shpk	3.150.000 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 28.02.2020, operatori ekonomik “RA-MI Kompani” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyen se:

- 1. Nuk keni në ekstraktin e QKB objektin e prokurimit për impiante ngritëse transportuese ose ashensorë sipas pikës 2.1 të k.v.k.*
- 2. Kontratat e ngjashme janë për materiale elektrike dhe jo për ashensorë dhe pjesë ashensorësh sipas pikës 2.2.4 të k.v.k.*
- 3. Nuk dispononi në listëpagesë 2 mekanik dhe 1 montator skele si dhe nuk keni paraqitur listëpagesën e janar 2020 sipas pikës 2.3.3 të k.v.k.*
- 4. Katallogu është fletëpalosje dhe jo katallog ku të tregohen pjesët e ashensorit me karakteristikat e përshkruara në specifikimet teknike si motorri, paneli kontrollit, sipas pikës 2.3.4 të k.v.k.*
- 5. Mungon autorizimi i prodhuesit të ashensorit të paraqitur në fletëpalosje ju keni një deklaratë ku distributori i autorizuar do të furnizojë dhe vendosë për ju ashensorin objekt tenderi. Në asnjë rast nuk provohet se “Germani” shpk është distributor shitës i ashensorëve “Montanari”, “Biofial”, etj, ju nuk keni plotësuar kriteret sipas pikës 2.3.5 të k.v.k.*

II.4.1. Në datën 05.03.2020, operatori ekonomik “RA-MI Kompani” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij nga kjo procedurë prokurimi në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë vijon:

Ne datën 05.02.2020 është publikuar ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit me Nr. REF- 48940-02-04-2020, me objekt: “Furnizim me nje ashensor te ri per godinen e hotelerise (Godina kater kateshe)”, me fond limit: 3,200,000 (Tre milion e dyqind mije) Lek pa TVSH, zhvilluar me dt. 24.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durres.

Ne datën 04.03.2020, operatori ekonomik “RA-MI KOMPANI” shpk paraqet ankese prane autoritetit kontraktor, konkretisht pretendohet si vijon: “Me date 05.02.2020 nepermjet sistemit te APP jemi njohur me procduren me objekt “Furnizim me nje ashensor te ri per godinen e hotelerise (Godina kater kateshe)”. Ne si shoqeri e qe kemi marre pjese ne kete procedure nuk jemi dakord me vleresimin per skualifikim nga autoriteti kontraktor si vijon”

- 1. Nuk keni në ekstraktin e QKB objektin e prokurimit për impiante ngritëse transportuese ose ashensorë sipas pikës 2.1 të k.v.k.*
- 2. Kontratat e ngjashme janë për materiale elektrike dhe jo për ashensorë dhe pjesë ashensorësh sipas pikës 2.2.4 të k.v.k.*
- 3. Nuk dispononi në listëpagesë 2 mekanik dhe 1 montator skele si dhe nuk keni paraqitur listëpagesën e janar 2020 sipas pikës 2.3.3 të k.v.k.*
- 4. Katallogu është fletëpalosje dhe jo katallog ku të tregohen pjesët e ashensorit me karakteristikat e përshkruara në specifikimet teknike si motorri, paneli kontrollit, sipas pikës 2.3.4 të k.v.k.*

5. Mungon autorizimi i prodhuesit të ashensorit të paraqitur në fletëpalosje ju keni një deklaratë ku distributori i autorizuar do të furnizojë dhe vendosë për ju ashensorin objekt tenderi. Në asnjë rast nuk provohet se “Germani” shpk është distributor shitës i ashensorëve “Montanari”, “Biofial”, etj, ju nuk keni plotësuar kriteret sipas pikës 2.3.5 të k.v.k.

Sqarojme autoritetin kontraktor sipas shtojces te bere me date 10.02.2020 ne ndryshim nga dokumentet standarte te tenderit (DST) te kerkuara nga AK, ne si operator ekonomik ofertues me oferte te rregullt nuk jemi dakord ne konkluzionet e nxjerra nga AK sepse

Se pari ne shtojcen e ndryshuar ne piken 2.1 kapaciteti ligjor profesional i operatoreve ekonomike **ISHTE** “Te kete objektin e prokurimit ne objektin e tij te aktivitetit ne Regjistrin Tregtar” dhe **BEHET** “Kjo pike e kriterave plotesohet me kriteret e pergjithshme te pranimit/kualifikimit te plotesuara me siper. Ne si operator ekonomik ne QKB ne objektin e aktivitetit kemi IMPORT-EXPORT, makineri pajisje industriale (ku ketu perfshihen dhe ashensorët sepse jane makineri). Nga ky kriter ne si operator ekonomik kemi gjithashtu Licensen NS-3 A (Impiante ngritese ashensore, shkalle levizese, transportues) qe vertetojme plotesimin e kesaj procedure prokurimi. Ju si AK e keni hequr vete kete kriter sipas shtojce se bere me date 10.02.2020 dhe per kete arsye ju nuk mund te na skualifikoni. Arsyetimi juaj nuk qendron.

Kontratat e ngjashme jane per materiale elektrike dhe jo per ashensore dhe pajisje ashensorësh sipas pikës 2.2.4. Referuar kontratave te ngjashme ne te cilat AK ka dal ne konkluzion qe ne si operator ekonomik nuk i kemi, duam te sqarojme AK qe ne kriteret e vendosura ne DST nuk ka kerkuar qe kontratat te jene te njejta me objektin e prokurimit dhe duke u bazuar ne parashikimet ligjore kjo kerkese nuk i sherben AK per permbushjen e qellimit te procedures dhe nuk ka pse te jete pjese e kerkesave per skualifikim per faktin se ne si operator ekonomik per kontratat e ngjashme, eshte paraqitur kontrate perkatese e realizuar me subjekt privat shoqeruar me fatura tatimore shitje ne te cilen perfshihen materiale elektrike qe nevojiten per ashensorin te tilla si panele, kablllo, automate te cilat jane te ngjashme me objektin e prokurimit. Ne do bejme furnizimin me materialet qe duhen per ashensorin. Arsyetimi juaj nuk qendron.

Nuk dispononi në listëpagesë 2 mekanik dhe 1 montator skele si dhe nuk keni paraqitur listëpagesën e janar 2020 sipas pikës 2.3.3 të k.v.k.

Ne DST persa i perket listepagesave eshte kerkuar sipas pikes 2.3.3

Ishte

Shoqeria te kete nje numer mesatar jo me te vogel se 8 (tete) punonjesish te siguruar per periudhen Janar 2019-Dhjetor 2019. Per te plotesuar kete kriter, duhet te paraqitet vertetim nga administrata tatimore per numrin e punonjesve te siguruar, per periudhen e kerkuar, te shoqeruar me listepagesat (formularët E-sig 025 a).

Behet

Per nga rendesia e Institucionit, me qellim realizimin e furnizimit dhe vendosjes sa me shpejt te jete e mundur te ashensorit, i cili eshte i domosdoshem per mirefunksionimin e Spitalit, Shoqeria te kete nje numer mesatar jo me te vogel se 6 (gjashte) punonjesish, nga te cilet te pakten:

- 1 inxhinier elektrik,*
- 1 inxhinier mekanik,*
- 2 mekanik,*
- 1 elektrikist,*
- 1 montatore per montimin e skeles, dhe*

Te cilet te jene te siguruar te pakten per 3 (tre) muajt e fundit. Per te plotesuar kete kriter, duhet te paraqitet vertetim nga administrata tatimore per numrin e punonjesve te siguruar, per periudhen e kerkuar, te shoqeruar me listepagesat (formularet E-sig 025 a).

Sqarojme AK se ne si operator ekonomik kemi paraqitur listepagesat dhe vertetim nga administrata tatimore per periudhen 3 mujore te fund vitit me kodet si:

7411.01 Elektracist

2151.01 Inxhinier Elektrik

2144.04 Inxhinier Mekanik

7421.17 Mekanik elektronik

7421.17 Mekanik elektronik

7115.08 Karpentier per skela (montator skelesh)

Referuar pikës 2.3.3 te ndryshuar sipas shtojces permbushim kriterin e vendosur nga AK me te gjitha kodet perkatese te kerkuara nga AK per 3 muajt e fundit. Arsyetimi juaj nuk qendron.

Katalogu është fletëpalosje dhe jo katalog ku të tregohen pjesët e ashensorit me karakteristikat e përshkruara në specifikimet teknike si motorri, paneli kontrollit, sipas pikës 2.3.4 të k.v.k.

Autoriteti kontraktor ne perfundimin e nxjerre per katalogun e ofertuar nga OE del ne vleresim qe eshte fletepalosje dhe jo katalog. Si operator ekonomik ne nuk jemi dakord me vleresimin e AK per shkak se ne piken 2.3.4 ka si kriter qe - Operatori ekonornik, duhet te paraqese katalog per ashensorin e ofruar ku te jepen sakte specifikimet teknike te kerkuara me siper keshtu qe OE ka paraqitur katalog me specifikimet e kerkuara te ashensorit sipas objektit te furnizimit shoqeruar me foto per spitale duke treguar me te te qarte. Arsyetimi juaj nuk qendron.

Mungon autorizimi i prodhuesit të ashensorit të paraqitur në fletëpalosje ju keni një deklaratë ku distributori i autorizuar do të furnizojë dhe vendosë për ju ashensorin objekt tenderi. Në asnjë rast nuk provohet se “Germani” shpk është distributor shitës i ashensorëve “Montanari”, “Biofial”, etj, ju nuk keni plotësuar kriteret sipas pikës 2.3.5 të k.v.k.

Përsa përket autorizimit të prodhuesit letra e paraqitur nga ne si OE për autorizim prodhuesi Germani shpk, autoritetit kontraktor i mjafton të shikoje në QKB kompaninë në fjalë (Tregtim, montim, mirëmbajtje, riparim ashensorë dhe shkallë të lëvizshme) do të thote që Germani shpk nuk është thjesht montues i ashensorit në vendodhjen e godinës sipas objektit të prokurimit por është (prodhues dhe montues) Arsyeja juaj nuk qëndron.

Për të gjitha këto pika të vlerësuara nga AK si të drejta për të, ne nuk jemi dakord duke bërë sqarimin pikë për pikë me të drejtën që kemi në si OE të gjykojmë për vlerësimin.

Ju lutemi të merrni dhe njëherë në shqyrtim ofertën tonë duke bërë gjykim të drejtë dhe të paanshem pasi oferta juaj rezulton e suksesshme

II.4.2. Me shkresën Nr. 555/3 prot, datë 06.03.2020 autoritetit kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së tij konkretisht për pikën 1 dhe 5 si më poshtë.

Kthim përgjigje për pikën 1:

Përsa i përket pretendimit të “RA-MI KOMPANI” Shpk për pikën 1, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur: Deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, në të cilën citohet se “Operatori ekonomik “RA-MI KOMPANI” sh.p.k është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit”; Ekstraktin e QKB, ku në objektin e aktivitetit, ndër të tjera citohet “Eksport-Import, shitja me shumicë dhe pakicë e mjeteve bujqësore me ose pa zinxhirë, të kapaciteteve të ndryshme, me ose pa rimorkio, makineri pajisje industriale”; Licencën NZ. 7495 të shoqërisë “RA-MI KOMPANI” shpk, për kategorinë NS-3A - Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).

Përsa paraqitur më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “RA-MI KOMPANI” sh.p.k, për pikën 1 qëndron.

Kthim përgjigje për pikën 5:

Përsa i përket pretendimit të “RA-MI KOMPANI” shpk për pikën 4, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se në pikën 2.3.5 të Kapacitetit Teknik kërkohet që: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje Autorizimi Distributori OE duhet të paraqesë në letër angazhim ose Akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, eëbsit kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”.

Nga verifikimi i autorizimit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, si edhe pas verifikimeve të kryera në Ekstraktin e QKB të “Germani” shpk, si edhe faqes zyrtare ëëë germani.com.al, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pranon pretendimet e operatorit “RA-MI Kompani” shpk, duke e kualifikuar për këtë kriter.

Përsa paraqitur më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “RA-MI Kompani” shpk për pikën 5 qëndron.

II.4.3. Në datën 12.03.2020, operatori ekonomik ankimues “RA-MI Kompani” shpk, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese si në autoritetin kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 630/1 prot., datë 27.03.2020, protokolluar me tonën me numër 306/2 prot., datë 06.04.2020, me objekt “Informacion” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “RA-MI Kompani” sh.p.k, mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: *“Kontratat e ngjashme janë për materiale elektrike dhe jo për ashensorë dhe pajisje ashensorësh sipas pikës 2.2.4. Referuar kontratave të ngjashme në të cilat AK ka dal në konkluzion që ne si operator ekonomik nuk i kemi, duam të sqarojmë AK që në kriteret e vendosura në DST nuk ka kërkuar që kontratat të jenë të njëjta me objektin e prokurimit dhe duke u bazuar në parashikimet ligjore kjo kërkesë nuk i shërben AK për përmbushjen e qëllimit të procedurës dhe nuk ka pse të jetë pjesë e kërkesave për skualifikim për faktin se ne si operator ekonomik për kontratat e ngjashme, është paraqitur kontratë përkatëse e realizuar me subjekt privat shoqëruar me fatura tatimore shitje në të cilën përfshihen materiale elektrike që nevojiten për ashensorin të tilla si panele, kablllo, automatë të cilat janë të ngjashme me objektin e prokurimit. Ne do bëjmë furnizimin me materialet që duhen për ashensorin. Arsyetimi juaj nuk qëndron”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 8, “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.2.4, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojë të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit, ne një vlerë jo me pak se 40% e vlerës

së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- Për kontratat e realizuara me institucione publike duhet të paraqesë kontratën/kontratat përkatëse të shoqëruar me vertetimet e realizimit me sukses te saj/tyre.
- Për kontratat e realizuara me subjekte private duhet të paraqesë kontratën/kontratat përkatëse dhe faturat tatimore te shitjes (ku të shprehen qartë datat, shumat dhe sasi të e mallrave te furnizuara)”.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimeve Elektronikë (SPE), konstatohet se operatori ekonomik “RA-MI Kompani” sh.p.k., për plotësimin e kriterit të mësipërm, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë Shitje datë 01.11.2019, me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me objekt shitje “Automat, Ndarësa, Panele”.
2. Faturë Tatimore Shitje me nr fature 02, datë 01.11.2019, me palë me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me vlerë 4.290.000 lekë pa tvsh.
3. Faturë Tatimore Shitje me nr fature 03, datë 02.11.2019, me palë me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me vlerë 7.800.000 lekë pa tvsh.
4. Faturë Tatimore Shitje me nr fature 04, datë 02.11.2019, me palë me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me vlerë 9.100.000 lekë pa tvsh.
5. Faturë Tatimore Shitje me nr fature 05, datë 04.11.2019, me palë me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me vlerë 441.200 lekë pa tvsh.
6. Faturë Tatimore Shitje me nr fature 06, datë 05.11.2019, me palë me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me vlerë 5.546.000 lekë pa tvsh.
7. Faturë Tatimore Shitje me nr fature 07, datë 05.11.2019, me palë me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me vlerë 8.750.000 lekë pa tvsh.
8. Faturë Tatimore Shitje me nr fature 08, datë 06.11.2019, me palë me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me vlerë 6.240.000 lekë pa tvsh.
9. Faturë Tatimore Shitje me nr fature 09, datë 06.11.2019, me palë me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me vlerë 4.520.000 lekë pa tvsh.
10. Faturë Tatimore Shitje me nr fature 10, datë 07.11.2019, me palë me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me vlerë 4.320.000 lekë pa tvsh.

11. Faturë Tatimore Shitje me nr fature 11, datë 07.11.2019, me palë me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me vlerë 6.075.000 lekë pa tvsh.
12. Faturë Tatimore Shitje me nr fature 12, datë 08.11.2019, me palë me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me vlerë 6.075.000 lekë pa tvsh.
13. Faturë Tatimore Shitje me nr fature 13, datë 09.11.2019, me palë me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me vlerë 7.280.000 lekë pa tvsh.
14. Faturë Tatimore Shitje me nr fature 14, datë 11.11.2019, me palë me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me vlerë 6.520.000 lekë pa tvsh.
15. Faturë Tatimore Shitje me nr fature 15, datë 11.11.2019, me palë me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me vlerë 4.800.000 lekë pa tvsh.
16. Faturë Tatimore Shitje me nr fature 16, datë 12.11.2019, me palë me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me vlerë 2.070.000 lekë pa tvsh.
17. Faturë Tatimore Shitje me nr fature 17, datë 12.11.2019, me palë me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me vlerë 2.376.000 lekë pa tvsh.

III.1.3. Në nenin 46 pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” b) “aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”.

III.1.4. Neni 27, pika 4, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet

të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ankimues “RA-MI Kompani” sh.p.k, ka dorëzuar Kontratë Shitje datë 01.11.2019, me palë shitëse “RA-MI Kompani” shpk dhe palë blerëse “Klosi-R Company” shpk, me objekt shitje “Automat, Ndarësa, Panele”, e shoqëruar me fatura tatimore shitje. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të sipërcituar të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit kualifikues, lidhur me punët e ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, konstaton se operatori ekonomik “RA-MI Kompani” sh.p.k duhet të dëshmonte me anë të dokumentacionit se ka kryer furnizime të ngjashme gjatë tre viteve të fundit në vlerën 40% të fondit limit). Referuar dokumentacionit të paraqitur nga ky operator ekonomik Komisioni gjykon se kontrata e paraqitura ka për objekt shitje “Automat, Ndarësa, Panel”, faturat e të cilave nuk përmbajnë element apo zëra të ngjashëm me objektin e prokurimit apo dhe me specifikimet teknike të mallit që do të furnizohet nga operatori ekonomik. Komisioni gjykon se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme ose jo nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës apo titullin e objektit por duhet parë në lidhje me zërat konkretë të furnizimeve të relizuara nga operatori ekonomik. Në rastin konkret jo vetëm objekti i kontratës së paraqitur prej këtij të fundit por edhe zërat e përshkruar në faturat tatimore të shitjes nuk përmbajnë elementë që të mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit i cila është i një natyre specifike dhe kërkon nga operatorët ekonomikë pjesmarrës që të kenë kryer eksperiencë të ngjashme me të njëjtën tipologji furnizimesh dhe instalimesh me kontratën në fjalë. KPP gjykon se eksperiencë e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues “RA-MI Kompani” shpk nuk dëshmon se ky i fundit ka realizuar objekte të ngjashme me natyrën e objektit të prokurimit duke mos krijuar kështu bindjen e autoritetit kontraktor për realizimin me sukses të kësaj kontrate.

KPP thekson se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë

të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues “RA-MI Kompani” shpk nuk disponon kontrata të ngjashme për përmbushjen me sukses të kapacitetit ekonomik dhe financiar të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit, e për rrjedhojë ndodhet në kushtet e mospërmbushjes të kriterit të vendosur në shtojcën 8/2, pika 2.2.4 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.6. K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit”*.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “RA-MI Kompani” shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “RA-MI Kompani” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërme nuk qëndron, pasi operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij

faktike juridike edhe pas arsyetimit të K.P.P., do të vijojë të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të operatorit ekonomik ankimuese nuk e ndryshon gjëndjen juridike të tij e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*RA-MI Kompani*” sh.p.k për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF- 48940-02-04-2020, me objekt: “*Furnizim me një ashensor të ri për godinën e hotelerise (Godina katër katëshe)*”, me fond limit 3,200,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 24.02.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 306 Protokoli, Datë 12.03.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NënKryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha